



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E SHËRBIMEVE FUNERALE
NJËSIA E PROKURIMIT

Data: 05/ 06/ 2026

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

Objekti i Procedurës: “Blerje vegla pune”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Vegla dore-44511000-5.Mjete te ndryshme- dore 44512000-2.Mistri dhe lopata - 44511100-6.Kazma - 44511310-1.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,439,909.18 (një milion e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntë pikë tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 76, pika 2, gërma ”b” të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar. Njësia e prokurimit për përlogaritjen e vlerës limit të objektit të kësaj procedure prokurimi iu referua studimit të tregut për marrjen e ofertave nga subjekte të ndryshme që operojnë në treg. U përdor kjo alternativë me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut, duke marrë parasysh edhe ndryshimet e çmimeve dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Njësia e Prokurimit për procedurën në fjalë vendos që lloji i procedurës së prokurimit të jetë: **Procedurë e Hapur e thjeshtuar, mallra.**

Arsyet e përdorimit të procedurës - “ E hapur e thjeshtuar”, Mallra, është sepse vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar.

Kriteret e përgjithshme të pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 2 pika “c”, nenit 78 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Funerale, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentim: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar) si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar): citojme Neni 83 i LPP (i ndryshuar) “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, mepërrjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP (i ndryshuar) “1. *Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, neni 76, 77, pika 1/a dhe 2; Nenin 25, 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe shtojcës 9 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të përlllogaritur**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43 pika 2/c dhe neni 55 pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar **në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të përlllogaritur**, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*
a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

Kjo vlere është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për këstet e maturuara për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit 9632, datë 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, për të gjitha vëndet ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas Regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore të parashikuara në ligjin 9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 ne DST, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentim: Kërkesa e mesepërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 6, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore", i ndryshuar, nën 40, në ligjin nr.131/2015 "Per QKB", i ndryshuar.

Per të vërtetuar që subjekti nuk është debitor në pagimin e taksave vendore të Qeverisjes Vendore dhe është subjekt që garanton qëndrueshmëri dhe është korrekt me detyrimet ligjore që ai ka. Janë kërkuar këstet e maturuara për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për të siguruar konkurrencë të lire për gjithë OE fizike apo juridike.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për këstet e maturuara për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen

e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Argumentim: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti

kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë te Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshme dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë që furnizimi, ngarkim-shkarkimi, transporti, do të bëhet me mjetet, puntoret dhe shpenzimet e operatorit ekonomik në destinacionin e përcaktuar nga autoritetit kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Në nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. përcaktohet se: “8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve teknike. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se, marrin përsipër realizimin e objektit të kontratës, nëpërmjet furnizimit, ngarkim-shkarkimit, transportit në destinacionin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor me mjetet, puntoret dhe shpenzimet e tyre, sipas nevojave të autoritetit kontraktor.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë fotografi/ katalogë/skeda teknike te prodhuesit ku të përfshihen specifikimet teknike për artikujt me nr. rendor: (1,2,5,6,8,10,12,14,16,19,21,22,26 dhe 35), sipas tabelës të përcaktuar në shtojcën 7 të DST. (Nëse fotografia/ katalogu/skeda teknike paraqitet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe).

Mosparaqitja sipas tabelës të përcaktuar në shtojcën 7 të DST, e fotografi/ katalogë/ skeda teknike është kusht për skualifikim.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, nenit 40, pika 6, gërma b) *ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;*

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi, lidhur me të gjitha detajet, llojin e materialit, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike.

4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikimin ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë" ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është vendosur në përputhje me nenin 79 " për “Sistemin e menaxhimit të cilësisë" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken 1 të nenit 44 "Kërkesat e cilësisë "të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit". Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të

jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

Shënim: Në mbështetje të nenit 88 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nëse kemi bashkim operatorësh ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, i ndryshuar me Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. ARGUMENTIM I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

1. **Karrocë ndërtimi me rrotë të montuar.** Kapaciteti mbajtës rreth 80 litra /160kg me përmasa 136x60x58 cm dhe doreza gome. Lllamarina e karrocës të jetë me spesor 2 mm. Karroca të jetë e pajisur me një rrotë. Rrota është material gome e fortë dhe rezistente ndaj degradimit dhe shkatërrimit. Model i plotë (gomë mishi), mundëson eliminimin e çarjes dhe dëmtimit të gomës në kantjer, ku prania e gozhdëve dhe elementëve shpues është e lartë me presion max: 130 Kpa/30 psi.
2. **Gomë karroce rezervë.** Produkt i përshtatshëm për karrocën e dorës, të cilat përdoren në fushën e ndërtimit. Rrota është material gome e fortë dhe rezistente ndaj degradimit dhe shkatërrimit. Model i plotë (gomë mishi), mundëson eliminimin e çarjes dhe dëmtimit të gomës në kantjer, ku prania e gozhdëve dhe elementëve shpues është e lartë me presion max: 130 Kpa/30 psi.
3. **Skuađer muratori.** Skuadra të jetë metalike me gjatësi 300 mm, punon deri në 360° dhe prej nje materiali çeliku.
4. **Vegla për mprehje kose.** Materiali është prej guri natyral me përmasa: 22x4.2x2 cm.
5. **Sfurk me bisht të montuar.** Sfurk çeliku me bisht druri natyral i tornuar të montuar. Përmasa e sfurkut të jetë 16cm, përdoret për mbledhjen dhe grumbullimin e materialeve si bar, kashtë etj. Gjatësia e bishtit 106 cm, me dorezë të shkurtër dhe me kapëse në formë rrethore.
6. **Kazma ndërtimi.** Kazmat të jenë material çeliku i farkëtuar. Peshë 2kg. Përmasat normale që përdoren në ndërtim. Kazëm e përshtatshme për punime të tokave të forta dhe tyerjen e materialeve të sërta të ndërtimit si: beton, gurë, pllaka, etj. Ndërtuar nga çelik cilësor dhe prodhuar me anë të procesit të farkëtimit, per rezistencë maksimale ndaj sforcimeve goditëse.
7. **Bishta kazme.** Bishtat të jenë dru natyral i tornuar dhe i stazhionuar, gjatësi normale 90cm.

8. **Lopata ndërtimi katrore.** Materiali i lopatës të jetë çelik i temperuar. Lopatë prej çeliku, e përshtashme për pastrimin dhe rrugëkalimin për punimin e tokës, për zhvendosjen e materialeve inerte etj.
9. **Bishta për lopatë katrore.** Bishtat të jenë dru natyral i tornuar dhe i stazhionuar. Gjatësi 120cm.
10. **Lopata ndërimi me hark.** Materiali i lopatës të jetë çelik i temperuar. Përmasat 40x20 cm, Lopatat metalike përdoret gjerësisht për gërmim apo pastrim dhe grumbullim të dherave apo materialeve të tjera inerte. E lehtë në përdorim dhe shumë e qëndrueshme duke përdorur dorezë mjaft të manovrueshme.
11. **Bishta lopate me hark.** Bishtat të jenë dru natyral i tornuar dhe i stazhionuar mjaft rezistent. Gjatësia 120 cm, është e përshtshme për lopata.
12. **Bela me këmbë.** Bel pune në formë ovale me punim majtas dhe përmasa 23x27 cm. E përshtatshme për punimin e tokës. Materiali prej çeliku i tempëruar siguron fortësi dhe qëndrueshmëri. Pesha: 1.0kg.
13. **Bishta për bela.** Bishtat të jenë dru natyral i tornuar dhe i stazhionuar. Gjatësi 120cm.
14. **Krëhër bari 30cm me dhëmbë me bisht të montuar.** Dhëmbët janë material çeliku i lyer me pjekje dhe përforcuar nga një krah. Gjerësia e krëhërit të jetë 30 cm. Bishtat të jenë dru natyral i tornuar dhe i stazhionuar, gjatësi 140cm. Përdoret për pastrim apo mbledhje të papastërtive në vende vështirësisht të aksesueshme.
15. **Sopata 600 gr me bisht të montuar.** Sopate me bisht fibra qelqi 600g. Me një peshë specifike dhe dorezë të rehatëshme. Kjo sopatë shërben për të çarë dru, apo prerje të degëve apo drurëve me diametër të vogël.
16. **Sharrë dore profesionale 50cm.** Prodhuar nga celik special veglash me gjatësi 50cm. Me tehe të temperuar dhe trajtuar termikisht dhe kimikisht. Mundëson prerje precize dhe humbje minimale të materialit drusor. Trajtuar me induksion në tehe për 45° dhe 90° kënd.
17. **Metër profesional 5m.** Metëri metalik me përmasë 5m x 19mm dhe kasë të gomuar, përdoret gjerësisht nga specialistë në fushën e ndërtimit etj. Metri është i prodhuar nga material çeliku rezistent nga goditjet ose përplasjet.
18. **Metër digital me lazer 20m. Metër digital lazer 20m** me përmasat 70x70x142mm, me kapacitet 0.15 -20m Njësia lazer është e lehtë për t'u përdorur. Me butonin vetë-shpjegues, që mundëson matjen menjëherë të çdo distance. Ndizet me anë të butonit poëer,dhe më pas mund të bëhen matje në mënyrë të vazhdueshme. Vlera aktuale e matur mund të ruhet me shtytjen e një butoni. Në sajë të teknologjisë inovative mundësohen matjet më të sakta. Ekran i zi me shkrim të bardhë e bën të lehtë për të lexuar rezultatet e matjes.
19. **Kosa bari.** Materiali të jetë çelik special me përmasa 60cm. Përdoret gjerësisht për prerjen ose pastrimin e barërave të ndryshëm.
20. **Bishta për kosa** Bishtat të jenë dru natyral i tornuar dhe i stazhionuar dhe i përforcuar nga një krah. Gjatësia 150cm.
21. **Gërshërë krasitje profesionale 50cm.** Gërshërët të jenë prej çeliku special veglash. Me dhëmbë të temperuara termikisht dhe kimikisht, për rezultat të shkelqyer në prerje. Të përshtatshme për dhënien e formës të bimëve dekorative. Gjatësia 50cm. Dorezat e tyre janë prej gome.

22. **Vare 10 kg me bisht të montuar.** Vareja është prej materiali çeliku të farkëtuar me rezistencë të lartë termike dhe bisht druri. Varreja të jetë me peshë 10kg.
23. **Bishta për vare.** Bishtat të jenë dru natyral i tornuar dhe i stazhionuar, gjatësi normale rreth 90cm.
24. **Litar najloni me shumë thurje, masa 16 mm.** Litari të jetë material najloni i fortë, me shumë thurje dhe me trashësi 16mm. Litari të jetë rezistent ndaj ujit, vajit, naftës, gërryerjeve, mykut dhe kimikateve.
25. **Levë metalike me gjatësi 1.5ml dhe $\phi 35$ mm.** Materiali çelik i farkëtuar me seksion ekzagonal, shumë rezistentë dhe me majë, për të hapur gropa apo për të krijuar hapësira midis objekteve si dhe për ti spostuar ato. Përmasa me gjatësi 1.5ml dhe $\phi 35$ mm.
26. **Kazëm me llapë të gjerë (capë).** Kazmat të jenë material çeliku me dy dhëmbë në njërin krah. E përshtatshme për punime të tokave të forta, prerje bimësh. Përmasa 24x5.8cm.
27. **Bishta për kazëm me llapë te gjerë.** Bishtat të jenë dru natyral i tornuar dhe i stazhionuar, gjatësi normale rreth 90cm.
28. **Rrjetë plastike masa 100mx2m.** Rrjetë plastike që përdoret për rrethim në kantier ndërtimi. Materiali të jetë rezistente gjatë përdorimit. Përmasat 100mx2m.
29. **Sqepar 600gr me bisht.** Sqepari të jetë me bisht druri, me peshë 600gr, i cili përdoret për punimin e armaturave të betonit. Materiali çelik.
30. **Mistri muratori me bisht.** Mistri me bisht druri, me përmasë 200 mm, gjerësi 33cm, është e prodhur nga çelik special, me majë të rrumbullakët.
31. **Spango. (50m/topi),** Materiali të jetë polipropilen me gjatësi 50m/topi. Kjo spango është rezistente ndaj kalbjes, rezistente ndaj vajrave e etj.
32. **Çekiç muratori me bisht të montuar.** Çekiçi të jetë material çelik me peshë 750gr dhe bisht me fibra qelqi, i cili përdoret për goditjen dhe nxjerrjen e gozhdeve nga druri. Ky çekiç të jetë i trajtuar termikisht.
33. **Nivelues muratori.** Niveluesi të jetë me kombinim metali alumini dhe plastike. Të jetë rezistente gjatë përdorimit. Gjatësia 60 cm.
34. **Dryna të mëdhenj 60mm.** Dryni të jetë me material bronzi me gjatësi 60 mm. Dryni përdoret për mbylljen e portave, garazheve, magazinave,. Dryni të ketë 3 çelësa.
35. **Pompa spërkatje.** Pompa e shpinës për spërkatje, prodhuar nga nje material rezistent plastik, përdoret për spërkatjen e bimëve, me një vëllim prej 20 litrash. Depozita të jetë e pajisur me rripa për t'u mbajtur në shpinë. Steka e spërkatjes dhe depozita të jenë të montuara.

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuar, në përputhje me parashikimet e proceseve të punës të përcaktuara në Nenin 16, “Sektorët e varrezave Sharrë dhe Tufinë”, dhe nenit 17 “Sektori i Varrezave në Njësitë Administrative”, në nënndarjet “Varrmihës”, ”Punëtor varrezash” dhe “Punëtor Varrezash në Njësitë Administrative”, të Urdhërit nr.27381/1, datë 8.8.2022, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, “Për miratimin e rregullores, për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Shërbimeve Funerale, Institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si

dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në specifikimet teknike të hartuara nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon mallrat e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

III. SASISA DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	EMERTIMI	Njesia	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Karroçë ndërtimi me rrotë të montuar	copë	96	Magazina e institucionit	30 ditë
2	Goma karroce rezervë	copë	96	Magazina e institucionit	30 ditë
3	Skuađer muratori	copë	8	Magazina e institucionit	30 ditë
4	Vegla për mprehje kose	copë	66	Magazina e institucionit	30 ditë
5	Sfurqe me bisht të montuar	copë	66	Magazina e institucionit	30 ditë
6	Kazma ndërtimi	copë	86	Magazina e institucionit	30 ditë
7	Bishta për kazma	copë	86	Magazina e institucionit	30 ditë
8	Lopata ndërtimi katrore.	copë	80	Magazina e institucionit	30 ditë

9	Bishta për lopata katrore	copë	80	Magazina e institucionit	30 ditë
10	Lopata ndërimi me hark	copë	66	Magazina e institucionit	30 ditë
11	Bishta për lopata me hark	copë	66	Magazina e institucionit	30 ditë
12	Bela me këmbë	copë	86	Magazina e institucionit	30 ditë
13	Bishta për bela	copë	86	Magazina e institucionit	30 ditë
14	Krehër bari 30 cm me dhëmbë me bisht të montuar	copë	86	Magazina e institucionit	30 ditë
15	Sopata 600 gr,me bisht të montuar	copë	66	Magazina e institucionit	30 ditë
16	Sharrë dore 50 cm profesionale	copë	66	Magazina e institucionit	30 ditë
17	Metër 5 m profesional	copë	11	Magazina e institucionit	30 ditë
18	Metër digjital me lazer 20m	copë	7	Magazina e institucionit	30 ditë
19	Kosa bari	copë	66	Magazina e institucionit	30 ditë
20	Bishta për kose	copë	66	Magazina e institucionit	30 ditë
21	Gërshërë krasitje të vogla profesionale 50 cm	palë	56	Magazina e institucionit	30 ditë
22	Vare 10 kg me bisht të montuar	copë	8	Magazina e institucionit	30 ditë
23	Bishta për vare	copë	8	Magazina e institucionit	30 ditë
24	Litar najloni me shumë thurje, me masa 16 mm	ml	200	Magazina e institucionit	30 ditë
25	Levë metalike masa 1.5ml x 35 mm fi	copë	8	Magazina e institucionit	30 ditë
26	Kazmë me llapë të gjerë	copë	76	Magazina e institucionit	30 ditë
27	Bishta për kazmë me llapë të gjerë	copë	76	Magazina e institucionit	30 ditë
28	Rrjetë plastike masa 100mx2m	ml	200	Magazina e institucionit	30 ditë

29	Sqepar 600 gr me bisht	copë	8	Magazina e institucionit	30 ditë
30	Mistri muratori me bisht	copë	8	Magazina e institucionit	30 ditë
31	Spango natyrale. (50m/topi)	topa	40	Magazina e institucionit	30 ditë
32	Çekiç muratori me bisht të montuar	copë	8	Magazina e institucionit	30 ditë
33	Nivelues muratori	copë	8	Magazina e institucionit	30 ditë
34	Dryna të mëdhenj 60mm	copë	8	Magazina e institucionit	30 ditë
35	Pompa Spërkatje	copë	86	Magazina e institucionit	30 ditë

Afatet e lëvrimit: Afati i lëvrimit është 30 ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

PËRLLOGARITJA E SIGURIMIT TË OFERTËS

Në mbështetje të nenit 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;”.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës për objektin **“Blerje vegla pune”** është **28,798.2** (njëzet e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë dy).

Afati i vlefshmërisë së ofertave është **150** (njëqind e pesëdhjetë ditë).

Në mbështetje të nenit 74 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 78 pika 1 të V.K.M nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit, sipas llojit të procedurës e tipit të kontratës.”*, njësia e prokurimit ka përdorur dokumentet standarte të tenderit të procedurës së hapur e thjeshtuar për mallra, të miratuar nga APP me Vendimin nr. 8, datë 23.09.2024 *“Për miratimin e dokumenteve standarte të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit “E Hapur e thjeshtuar”*”.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: **“Blerje vegla pune”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT